



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

KOLEGJI "BIZNESI"

№. 207/19 Data: 20.05.2019
PRISHTINË

Gjakovë, 28/05/2019

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NDËRMJET

Kolegjit "BIZNESI"

dhe

Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative Gjakovë

Kolegji "BIZNESI" dhe Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative në Gjakovë, të cilëve dokumenti i referohet si partnerë, e që lidhet në bazë vullnetare sipas të cilës të dy partnered marrin obligime që në kushtet e përcaktuara me këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, të avancojnë dhe promovojnë zhvillimin e e resurseve njerëzore në Kosovë.

I. Natyra e bashkëpunimit

Qëllimi

1. Palet në marrëveshje do të angazhohen për krijimin e kushteve më të mira, të cilat do të avancojnë, shkallën e zhvillimit njerëzor, nepërmjet krijimit të mundësive dhe hapjen e mundësive për të mbaruar mësimin praktikë, prej dy javë deri në dy muaj të studentëve në Drejtorinë për Punë të Përgjithshme Administrative Gjakovë, në sektorët ku ka mundësi të sistemit të studentëve, si dhe krijimin e mundësive, sa herë që një gjë e tillë është e mundur, për punësimin e të rinjve që përfundojnë studimet me sukses në Kolegjin "Biznesi".
2. Kjo marrëveshje definohet si pako, për krijimin e mundësive për individët dhe për grupet e individëve, që t'u shërbejnë në të ardhmen nevojave zhvillimore në Kosovë dhe avancimin e resurseve njerëzore

Emërtimi i shërbimeve

3. Emërtimi i shërbimeve do të jetë "zhvillimi i resurseve njerëzore" dhe do t'i referohet "partneritetit strategjik ndërmjet Kolegjit "Biznesi" dhe Drejtorinë për Punë të Përgjithshme Administrative Gjakovë.

II. Kushtet e Partneritetit/bashkëpunimit

1. Nga momenti i nënshkrimit të kësaj marrëveshje, e njëjta do të jetë e plotëfuqishme për periudhën një vjeçare
2. Shqyrtimi, ndryshimi apo shkëputja e kësaj marrëveshje, mund të bëhet në çdo kohë, në rast se palët merren vesh me shkrim për një gjë të tillë.
3. Varësisht nga interesi dhe nevojat e palëve, pas kalimit të afatit të caktuar, në paragrafin paraprak, mund të lidhet marrëveshje e re bashkëpunimi.
4. Mos lidhja e marrëveshjes së re, nuk do të thotëse kjo marrëveshje do të konsiderohet e vazhduar.

III. Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Kolegji “Biznesi” dhe Drejtorinë për Punë të Përgjithshme Administrative Gjakovë, në sektorët që ka mundësi të sistemit të studentëve, do të përcaktojnë numrin e studentëve që do të aftësohen nëpërmjet mësimit praktikë në njësitë organizative të Drejtorinë për Punë të Përgjithshme Administrative Gjakovë
2. Kolegji “Biznesi”, partnerit të kësaj marrëveshje Drejtorinë për Punë të Përgjithshme Administrative Gjakovë, do t’i dorëzoj listën me emrat e studentëve të përzgjedhur dhe të paraparë për aftësimin praktik në këtë drejtori.
3. Mësimi praktikë i studentëve të Kolegjit “Biznesi” në Drejtorinë për Punë të Përgjithshme Administrative Gjakovë, në sektorët ku ka mundësi të sistemit të studentëve, do të zgjasë prej dy javë deri në një muaj. Kohëzgjatjen e praktikës, partneret e caktojnë nga rasti në rast.
4. Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative Gjakovë, në sektorët ku ka mundësi të sistemit të studentëve të Kolegjit “Biznesi”, të cilët kanë përfunduar studimet me notë të lartë mesatare si dhe studentëve që kanë mbaruar paraprakisht punën praktike në këtë institucion.

IV. Komunikimi dhe Marketingu Strategjik


1. Kolegji “Biznesi”, Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative Gjakovë, do të punojnë bashkarisht për promovimin e nismave të përbashkëta, për thellimin e marrëdhënieve me publikun, për promovimin e ndërsjellë të iniciativave.
2. Kolegji “Biznesi”, Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative Gjakovë, do të angazhohen brenda mundësive që në rastin e fillimit por edhe të përfundimit të nismave si punësimit dhe aftësimin nëpërmjet punës praktike të studenteve, të zhvillojmë materialet e përbashkëta promovuese, siç janë komunikatat për shtyp, konferencat e të ngjashme.

Komunikatat e përbashkëta, do të përmbajnë logot e të dyja palëve nënshkruese të marrëveshjes, Kolegji “Biznesi”, dhe Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative Gjakovë. Përmbajtjet e publikimeve promovuese do të publikohen në WEB faqet e të dy entiteteve.

V. Fuqizimi i marrëveshjes


1. Marrëveshja hyn në qufi ditën e nënshkrimit nga palët e involvuara.
2. Kjo marrëveshje është përpiluar në katër (4) kopje autentike, nga dy (2) kopje, për secilën palë.
3. Palët lexuan marrëveshjen dhe me nënshkrimet e veta pranojnë përmbajtjen e saj për të vete.

Kolegji "Buznesi"
Dega në Gjakovë



Prof. Dr. Shyqeri Kabashi

Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative



Hamir Fetahaj